# Akt Themelimi

## “UNIVERS-ALB” SH.A.
## Shoqeri ANONIME

### I. Themelimi

Aksioneret themelues:

1. **Shoqeria Tregetare ENAR Saglik Hizmetleri**, Tibbi Mazleme, Egitim, Dls Ticaret Limited Sirketi, regjistruar ne Regjistrin Tregetar Turk me 27.04.2204, perfaqesuar nga Drejtori i Pergjithshem dhe njekohesisht mbartesi i 98% te aksioneve **Dr. Neyir Tuncay Eren**, nenshtetas Turk, i datelindjes 1961, me numer pasaporte TR-A 243171.

2. **Shoqeria Tregetare TEK-IMAS** Makinalari Muteahhitlik Madencilik Muhendislik Sanayi ve Ticaret Anonim Sirketi, regjistruar ne Zyren e Regjistrit Tregetar te Ankarase, Turqi me nr. Regjistri 106369, me adrese, Turan Gunes, Bulvari, Hilal Mahallesi, 4, Cadde, no. 64, Kat 1 Daire 1-2, Cankaya, Ankara, Turqi, perfaqesuar nga **Z. Ahmet Malkan**, Kryetar i Keshillit Drejtues, nenshtetas Turk, i datelindjes 25.11.1952, vendlindja Elazig, Turqi, vendbanimi Ankara Turqi, me numer pasaporte TR-A-107683.

3. **Z. Klodian Allajbeu**, i biri i Fadilit, shtetas shqiptar, lindur ne Berat me 21.04.1978, me adresa e banimi Lagja : Komuna e Parisit. Tirane dhe me numer pasaporte Z 1017136.

deklarojne themelimin e shoqerise anonime "Univers – Alb" sh.a, person juridik shqiptar, bazuar ne ligjin nr. 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare"., me kohezgjatje te pacaktuar, me seli ne adresen rr. Punetoret e Rilindjes, kulla 1, kati 7, Tirane Shqiperi.

**II. Objekti**

Objekti i Shoqerise eshte :

Investime dhe Sherbime ne fushen e Mjekesise dhe Shendetit; ngritja dhe menaxhimi i spitaleve dhe klinikave private, marrja dhe/ose dhenia me qera e spitaleve dhe klinikave dhe manaxhimi dhe administrimi i tyre, aparaturave mjekesore dhe barnave medicinale, importi, eksporti si dhe prodhimi i materialeve dhe pajisjeve nje dhe shume perdorimeshe shendetesore dhe mjekesore, etj

Investigim ne cdo dege dhe ne cdo fushe te sektoreve te puneve publike; Importimin, eksportimin, transportin, shitjen, lisingun, dhenien dhe marrjen me qera si dhe te gjitha veprimtarite e tjera tregtare ne funksion te mjeteve dhe makinerive te industrise se ndertimit, si dhe sigurimin e zbatimit te koncesionit.

Importimin dhe eksportimin e materialeve te paperpunuara dhe te perpunuara te ndertimit, materialeve aksesore si dhe te mallrave dhe materialeve te cdo lloji.

Fushat kryesore te aktivitetit te shoqerise jane:

a. Industria e ndertimit,

b. Shit blerja, dhenia apo marrja me qera te objekteve, aseteve, produkteve dhe mallrave qofshin keto te luajtshme apo te paluajtshme,

c. Riparimi i pajisjeve dhe puneve obliguese ne montim,

d. Pergatitje projektesh ne fusha te ndryshme,

e. Konsulence teknike ne fushen e Ndertimit si dhe ne fusha te tjera,

f. Pjesemarrje ne marreveshje dhe tendera te lidhura me sherbimet inxhinierike, marrja persiper e hartimit dhe dizenjimit te projekteve dhe implementimi (zbatimi) i tyre vetem ose ne bashkepunim me te tjere,

g. Kontraktimi nga pale te treta apo tua bej kete pune te tjereve dhe te marre cdo lloj leje apo aplikimi ne lidhje me keto pune,

h. Investime te ndryshme, duke perdorur Fondet e Institucioneve Financiare vendase apo te huaja,

i. Cdo aktivitet tjeter, i lidhur ne menyre te drejteperdrejte apo qe ka lidhje me aktivitetet e siperpermendura, i cili konsiderohet fitimprures, nga organet drejtuese te shoqerise.

Ne lidhje me keto sherbime, shoqeria mund te kryeej keto aktivitete:

a. Te prodhoje dhe te importoje cdo tip makine, pajisje dhe materiale ne fushen e mjeksise dhe shendetit e ndertimit

b. Te realizoje reklamen dhe marketingun, te bleje, te marre me qera dhe kur te jete e nevojshme ti exportoje apo ti nxjerre prej dore.

c. Projektimi i pyjeve, depozitimi i prodhimeve me berjen e rrugeve, te marre pjese ne tenderat e tyre, per prodhimet e nevojshme te nxjerre pervetesime; reklamimi dhe marrja-dhenia, te beje importimin –eksportimin dhe marketingun e saj.

d. Te realizoje importin dhe marketingun e materialeve te nevoshme per ndertimet industriale dhe tregtare, cdo tip makinerie si makina pune, importin e cdo pjese dhe pjese nderrimi me rruge transporti tokesore dhe detare.

e. Te marre cdo lloj leje ne lidhje me minerale qymyr, mermer, hekur, alumin, plumb, etj; si dhe te hape miniera apo ti marre ato ne koncesion te beje prodhimin dhe exportin e cdo lloj makinerie dhe pjese nderrrimi me materiale te fabrikuara dhe gjysem te fabrikuara.

f. Te realizoje prodhimin e mallrave qe jane te lidhura me fushat e aktivitetit te shoqerise, per prodhimin e ketyre mallrave te beje prodhimin e pjeseve aksesore dhe qe do te perdoren si mallra dytesor, te beje blerjen, shitjen, importin, eksportin.

g. Te realizoje perfaqesimin dhe distribuimin e kompanise ne lidhje me fushat e aktivitetit te shoqerise, dhe te hape zyra perfaqesie dhe agjensi brenda dhe jashte vendit.

h. Te ndertoje institucione industriale, tregtare ne lidhje me temen e biznesit, ti menaxhoje ato pjeserisht, ti jape pjeserisht apo plotesisht me qera, ti shese ti marre me qera apo te bleje institucionet e te treteve.

## III. Statuti

Aksioneret Themelues deklarojne pajisjen e shoqerise me statut, te firmosur prej tyre dhe te noterizuar. Statuti i aneksohet ketij akti.

## IV. Kapitali

Vlera e Kapitalit Themeltar eshte **2 000 000 Leke**. Kapitali ndahet ne **200 aksione nominative** dhe te pandashme, secila me vlere nominale prej **10 000 Leke**.

Cdo aksion i jep te drejten e nje vote zoteruesit te saj. Pronesia e aksioneve pasqyrohet ne librin e aksioneve te mbajtur nga shoqeria.

## V. Aksioneret, nenshkrimi dhe shlyerja e Kapitalit

Aksionet jane perkatesisht ne pronesi te:

| Emri | Numri i aksioneve | Pjesemarrja ne perqindje (%) | Vlera totale e kontributit (ne leke) |
|---|---|---|---|
| **Shoqeria "TEK-IMAS"** | 160 | 80% | 1,600,000 |
| **Shoqeria "ENAR Saglik Hizmetleri "** | 20 | 10% | 200,000 |
| **Klodian Allajbeu** | 20 | 10% | 200,000 |

Aksionet jane nenshkruar krejtesisht nga aksioneret nepermjet Buletineve te nenshkrimit.

Ne momentin e themelimit te shoqerise, aksionet jane shlyher ne ¼ e vleres se tyre nominale :

| | |
|---|---|
| **Shoqeria "TEK-IMAS"** | 400,000 Leke |
| **Shoqeria "ENAR Saglik Hizmetleri "** | 50,000 Leke |
| **Klodian Allajbeu** | 50,000 Leke |

Ne Total, aksioneret themelues kane shlyer ¼ e kapitalit themeltar, te barabarte me 500 000 Leke. Shlyerja e vleres se mbetur behet sipas proçedurave dhe afateve te percaktuar nga Drejtori.

Aksioneret Themelues autorizojne zotin **Klodian Allajbeu** si mandatmbajtes qe te depozitoje fondet per kapitalin themeltar. Mandatmbajtesi harton nje çertifikate ku evidencohen shumat e derdhura nga aksioneret, mbeshtetur ne nenin 90 te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare".

Pronesia e aksioneve pasqyrohet ne librin e aksioneve te mbajtur nga shoqeria.

Aksioneret perballojne humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se kontributeve te tyre ne kapitalin themeltar.

## VI. Keshilli Mbikqyres

Keshilli Mbikeqyres perbehet nga 3 anetare. Dy nga anetaret e ketij Keshilli zgjidhen nga Asambleja e zakonshme e Aksionereve. Anetari i trete i Keshillit Mbikqyres zgjidhet nga punemarresit me votim te fshehte.

Anetaret e pare te Keshillit Mbikqyres jane:

1. **Z. Ahmet Malkan,** Kryetar i Keshillit Mbikqyres
2. **Dr. Neyyir Tuncay Eren,** Zevendeskryetar i Keshillit Mbikqyres

Mandati i anetareve te Keshillit Mbikeqyres eshte 4 (kater) vjet. Ata jane te rizgjedhshem. Anetaret e Keshillit Mbikeqyres jane persona fizike ose juridike. Drejtori nuk mund te jete anetar i Keshillit Mbikqyres.

## VII. Drejtori

Drejtori i pare i shoqerise eshte **Z. Klodian Allajbeu.** Te drejtat dhe detyrimet e tij percaktohen ne aktin e emerimit.

Keshilli Mbikqyres autorizon Drejtorin z. Allajbeu, te kryeje çdo gje te nevojshme, perfshire por pa u limituar ne: pergatitjen e akteve, kerkesave, dokumentave, nenshkrimin e tyre ne emer te shoqerise ne themelim, depozitimin e kontributeve ne Banke etj, me qellim regjistrimin e shoqerise "Univers – Alb" sh.a, ne Regjistrin Tregtar te Gjykates se rrethit gjyqesor te Tiranes, si edhe ne cdo organ tjeter shqiptar sipas ligjeve shqiptare.

## VIII. Organi I Kontrollit

Kontrolli i shoqerise ushtrohet nga nje ekspert kontabel te autorizuar. Eksperti i Pare kontabel i autorizuar eshte **Paqesor Qato**.

*Ky akt themelimi nenshkruhet, ne prani te noterit, nga aksioneret themelues, me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, sot me* 17/10/06 , *ne* Tirane .

## AKSIONERET THEMELUES TE SHOQERISE

Shoqeria Tregtare
**« ENAR Saglik Hizmetleri »**
**Dr. Neyir Tuncay Eren**

Neyir Tuncay Eren

Shoqeria Tregtare
**« TEK-IMAS »**
**Z. Ahmet Malkan** Ahmet Malkan

**Z. Klodian Allajbeu**

Z. Klodian Allajbeu

Përkthyes
Dorian Ruci

## STATUTI I SHOQERISE TREGTARE
## "UNIVERS-ALB" SH.A.

**KAPITULLI I**

**KRIJIMI, FORMA, EMERTIMI, KOHEZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1**

1.1. Shoqeria Anonime "UNIVERS-ALB " Sh.A." eshte nje shoqeri anonime, *personi juridik shqiptar. Aktiviteti i kesaj shoqerie rregullohet nga ky statut dhe* nga Ligji nr. 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare".

1.2. Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentat themeluese (akt themelimi dhe statut).

**NENI 2**

2.1. Shoqeria ka seline ne Tirana, ne adresen Rr. Punetoret e Rilindjes, Kulla 1, kati 7, Tirane Shqiperi.

2.2. Pervec veprimtarise ne nivel lokal, shoqeria ka te drejten e krijimit dhe mbylljes se filialeve, agjensive dhe dhe zyrave te perfaqesimit brenda apo jashte territorit te vendit.

2.3. Shoqeria ka vulen e saj.

**NENI 3**

3.1 Kohezgjatja e shoqerise eshte me fat te pacaktuar

3.2 Ne perputhje me kete statut, shoqeria mund te mbylle veprimtarine e saj kur e sheh te arsyeshme apo ne rastet e parashikuara me ligj.

**NENI 4**

Objekti i Shoqerise eshte :

4.1. Investime dhe Sherbime ne fushen e Mjekesise dhe Shendetit; ngritja dhe menaxhimi i spitaleve dhe klinikave private, marrja dhe/ose dhenia me qera e spitaleve dhe klinikave dhe manaxhimi dhe administrimi i tyre, aparaturave mjekesore dhe barnave medicinale, importi, eksporti si dhe prodhimi i materialeve dhe pajisjeve nje dhe shume perdorimeshe shendetesore dhe *mjekesore, etj*

4.2. Investigim ne cdo dege dhe ne cdo fushe te sektoreve te puneve publike; *Importimin, eksportimin, transportin, shitjen, lisingun, dhenien dhe marrjen me* qera si dhe te gjitha veprimtarite e tjera tregtare ne funksion te mjeteve dhe makinerive te industrise se ndertimit, si dhe sigurimin e zbatimit te koncesionit.

4.3. Importimin dhe eksportimin e materialeve te paperpunuara dhe te perpunuara te ndertimit, materialeve aksesore si dhe te mallrave dhe materialeve te cdo lloji.

4.4. Fushat kryesore te aktivitetit te shoqerise jane:

a. Industria e ndertimit,

b. Shit blerja, dhenia apo marrja me qera te objekteve, aseteve, produkteve dhe mallrave qofshin keto te luajtshme apo te paluajtshme,

c. Riparimi i pajisjeve dhe puneve obliguese ne montim,

d. Pergatitje projektesh ne fusha te ndryshme,

e. Konsulence teknike ne fushen e Ndertimit si dhe ne fusha te tjera,

f. Pjesemarrje ne marreveshje dhe tendera te lidhura me sherbimet inxhinierike, *marrja persiper e hartimit dhe dizenjimit te projekteve dhe implementimi (zbatimi)* i tyre vetem ose ne bashkepunim me te tjere,

g. Kontraktimi nga pale te treta apo tua bej kete pune te tjereve dhe te marre cdo lloj leje apo aplikimi ne lidhje me keto pune,

h. Investime te ndryshme, duke perdorur Fondet e Institucioneve Financiare vendase apo te huaja,

i. Cdo aktivitet tjeter, i lidhur ne menyre te drejteperdrejte apo qe ka lidhje me aktivitetet e siperpermendura, i cili konsiderohet fitimprures, nga organet drejtuese te shoqerise.

4.5. Ne lidhje me keto sherbime, shoqeria mund te kryeej keto aktivitete:

a. Te prodhoje dhe te importoje cdo tip makine, pajisje dhe materiale ne fushen e mjeksise dhe shendetit e ndertimit

b. Te realizoje reklamen dhe marketingun, te bleje, te marre me qera dhe kur te jete e nevojshme ti exportoje apo ti nxjerre prej dore.

c. Projektimi i pyjeve, depozitimi i prodhimeve me berjen e rrugeve, te marre pjese ne tenderat e tyre, per prodhimet e nevojshme te nxjerre pervetesime; reklamimi dhe marrja-dhenia, te beje importimin –eksportimin dhe marketingun e saj.

d. Te realizoje importin dhe marketingun e materialeve te nevoshme per ndertimet industriale dhe tregtare, cdo tip makinerie si makina pune, importin e cdo pjese dhe pjese nderrimi me rruge transporti tokesore dhe detare.

e. Te marre cdo lloj leje ne lidhje me minerale qymyr, mermer, hekur, alumin, plumb, etj; si dhe te hape miniera apo ti marre ato ne koncesion te beje prodhimin dhe exportin e cdo lloj makinerie dhe pjese nderrimi me materiale te fabrikuara dhe gjysem te fabrikuara.

f. Te realizoje prodhimin e mallrave qe jane te lidhura me fushat e aktivitetit te shoqerise, per prodhimin e ketyre mallrave te beje prodhimin e pjeseve aksesore dhe qe do te perdoren si mallra dytesor, te beje blerjen, shitjen, importin, eksportin.

g. Te realizoje perfaqesimin dhe distribuimin e kompanise ne lidhje me fushat e aktivitetit te shoqerise, dhe te hape zyra perfaqesie dhe agjensi brenda dhe jashte vendit.

h. Te ndertoje institucione industriale, tregtare ne lidhje me temen e biznesit, ti menaxhoje ato pjeserisht, ti jape pjeserisht apo plotesisht me qera, ti shese ti marre me qera apo te bleje institucionet e te treteve.

## KAPITULLI II
## KAPITALI THEMELTAR, AKSIONET

### NENI 5

5.1. Vlera e Kapitalit Themeltar eshte **2 000 000 Leke**.

5.2. Kapitali ndahet ne **200 aksione nominative**, secila me vlere prej **10 000 Leke**.

5.3 Aksionet jane nominative dhe te pandashme.

5.4 Ne momentin e themelimit te shoqerise, aksionet nenshkruhen krejtesisht dhe shlyhen ne ¼ e vleres se tyre nominale. Shlyerja e vleres se mbetur behet sipas nje proçedure te percaktuar me vendim te Drejtorit.

5.5. Cdo aksion i jep te drejten e nje vote zoteruesit te saj.

5.6. Pronesia e aksioneve pasqyrohet ne librin e aksioneve te mbajtur nga shoqeria.

5.7. Aksioneret perballojne humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se kontributeve te tyre ne kapitalin themeltar.

### NENI 6

6.1 Libri i aksioneve mbahet nga Drejtori i shoqerise, ne seline e shoqerise. Ai *permban ne çdo kohe: emrat, mbiemrat dhe adresat e aksionereve, numrin e* aksioneve ne pronesi te secilit aksioner, vleren nominale te aksioneve, te dhenat mbi transferimin e aksioneve.

6.2. Secili aksioner ka te drejte te konsultoje ne çdo kohe Librin e aksioneve, te verifikoje te dhenat qe i perkasin dhe te kerkoje dhe te marre nje ekstrakt nga Libri i aksioneve, mbi te dhenat qe i perkasin, te vulosur me vulen e shoqerise.

6.3 Te dhenat e Librit te Aksioneve jane rreptesisht sekrete per sa i perket te treteve. *Ato mund t'i behen te ditur te treteve vetem me miratimin e aksionereve.* Drejtori eshte pergjegjes per mbajtjen e Librit te Aksioneve dhe perdorimin e tij sipas Ligjit dhe ketij statuti.

**NENI 7**

7.1 Aksionet e shoqerise jane lirisht te transferueshme midis aksionereve dhe / *ose tek persona te trete dhe / ose ne rast trashigimie, ndarjeje pasurie ndermjet* bashkeshorteve; ne asnje rast, nuk kerkohet miratimi i Asamblese apo organeve te shoqerise.

7.2. Transferimi i aksioneve duhet te pasqyrohet ne Librin e aksioneve te mbajtur nga shoqeria. Ne liber shenohen data e transferimit, emrat, mbiemrat dhe adresat e aksionerit te vjeter dhe te ri, vlera nominale dhe numri i aksioneve te transferuar.

**NENI 8**

8.1 Kapitali themeltar zmadhohet nepermjet emetimit te aksioneve te reja ose nepermjet rritjes se vleres nominale te aksioneve ekzistuese. Aksionet e reja shlyhen me para ne dore, me kompensim te nje kredie ne para te kerkueshme dhe te detyruar per t'u shlyer nga shoqeria, me perfshirje te rezervave, fitimeve, primeve te emetimit, me kontribut ne natyre ose me shnderrimin e obligacioneve.

8.2. Kapitali themeltar mund te zmadhohet me Vendim te Asamblese se Jashtezakonshme, e cila vendos mbi bazen e Raportit te Drejtorit.

8.3 Bejne perjashtim nga rregulli i mesiperm:

a. Zmadhimi i kapitalit nepermjet rritjes se vleres nominale te aksioneve behet vetem me pelqimin unanim te aksionereve.

b. Zmadhimi i kapitalit nepermjet perfshirjes se rezervave, te fitimeve ose primeve te emetimit behet me Vendim te Asamblese se Zakonshme.

8.4. Aksionet e reja emetohen me vleren nominale ose me vleren e rritur qe perfshin primen e emetimit.

8.5. Aksioneret kane te drejte perparesie ne nenshkrimin e zmadhimit te kapitalit, proporcionalisht me shumen e aksioneve qe zoterojne.

8.6. Asambleja kompetente i delegon Drejtorit kompetencen per te percaktuar modalitetet proçedurat dhe realizimin e zmadhimit te kapitalit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe kete statut.

**NENI 9**

9.1. Zvoglimi i kapitalit vendoset nga Asambleja e jashtezakonshme.

9.2. Asambleja i delegon Drejtorit kompetencen per te percaktuar modalitetet proçedurat dhe realizimin e zvoglimit te kapitalit, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe kete statut.

9.3. Zvoglimi I kaptialit I prek aksioneret ne menyre te barabarte, ne perpjestim me vleren e aksioneve qe zoterojne.

**KAPITULLI III**

**ORGANET E SHOQERISE**

**A. ASAMBLEJA**

**NENI 10**

10.1. Organi vendimmarres i shoqerise eshte Asambleja e Aksionereve. e cila perbehet nga te gjithe aksioneret.

10.2. Mbledhjet e asamblese se aksionereve mund te jene te Zakonshme ose te Jashtezakonshme.

10.3. Mbledhjet mbahen ne seline e shoqerise, apo edhe ne nje vend tjeter, i cili u behet I ditur paraprakisht aksionereve, sipas rregullave te njoftimit.

**NENI 11**

11.1. Mbledhja e Asamblese se Aksionereve thirret nga Kryetari i Keshillit *Mbikeqyres ose nga Drejtori. Ajo mund te thirret edhe nga: Eksperti kontabel i* autorizuar, nga nje mandatmbajtes I caktuar nga gjykata, mbas kerkeses se cdo te interesuari per nje rast urgjent, ose te nje ose disa aksionereve qe zoterojne 1/10 e kapitalit; nga likuiduesit.

11.2. Mbledhja e Asamblese se Aksionereve konsiderohet e thirrur ne menyren e duhur, *edhe nese nuk jane respektuar formalitetet qe rregullojne proçeduren* e thirrjes se saj, me kusht qe te jene te pranishem, apo te perfaqesuar me prokure te gjithe Aksioneret.

**NENI 12**

12.1. Mbledhjet e Asamblese se Aksionereve drejtohen nga Kryetari i Keshillit Mbikeqyres.Ne mungese te tij keto mbledhje mund t'i drejtoje edhe nje aksioner i emeruar nga Mbledhja e Aksionereve.

12.2. Mbledhja e Asamblese se Aksionereve cakton nje sekretar , i cili mund te jete jo aksioner.

12.3. Aksioneret mund te perfaqesohen ne Mbledhjen e Asamblese se Aksionereve nga nje aksioner tjeter apo bashkeshorti, qe duhet te jene te pajisur me prokure.

12.4. Drejtuesi i Mbledhjes ka kompetence te plote te verifikoje prokurat dhe rregullsite e tyre, apo arritjen e shumices se kerkuar, me qellim qe vendimet e marra te jene te vlefshme.Pas kesaj, drejtuesi I mbledhjes vendos zhvillimin e mbledhjes. Drejtuesi I mbledhjes ka te drejte gjithashtu te drejtoje diskutimet dhe proceduren e votimit.

12.5. Thirrja e Mbledhjeve te Asamblese se Aksionereve behet nepermjet njoftimit me leter rekomande ose nepermjet lajmerimit ne nje gazete te autorizuar, te pakten 15 dite para Mbledhjes. Njoftimi duhet te permbaje: diten, oren, vendin ku do te mbahet mbledhja; percaktimin e natyres se saj ( e zakonshme, e jashtezakonshme) si dhe rendin e dites. Drejtoria ju ve ne dispozicion aksionereve te gjitha materialet e nevojshme, te pakten 15 dite para Mbledhjes.

12.6. Proces verbalet e Mbledhjes nenshkruhen rregullisht nga drejtuesi I saj, sekretari si dhe cdo aksioner, qe deshiron te nenshkruaje.Vendimet e Asamblese firmosen nga aksioneret e pranishem.Cdo aksioner i pranishem ose jo ne

mbledhje, ka te drejte qe kundrejt pageses, te marre kopje te vendimit te mbledhjes.

**NENI 13**

13.1. Mbledhja e Asamblese se Zakonshme te Aksionereve, mbahet te pakten *nje here ne vit, brenda gjashte muajsh nga fundi I vitit financiar, me qellim qe te* diskutohen, shqyrohen dhe miratohen raportet financiare te vitit te kaluar. Ajo ka te gjitha kompetencat sipas ligjit dhe ketij statuti perveç miratimit te ndryshimeve te statutit.

13.2. Mbledhja e Asamblese se Zakonshme te Aksionereve, konsiderohet e vlefshme *ne mbledhjen e saj te pare, nese marrin pjese Aksioneret, te pranishem* apo te perfaqesuar,qe zoterojne te pakten 25% te aksioneve me te drejte vote. Ne rast se nuk arrihet shumica e kerkuar me siper, mbahet nje mbledhje e dyte pa u kerkuar nje quorum.

13.3. Mbledhja e Asamblese se Zakonshme te Aksionereve merr vendim me *shumicen e votave qe zoterojne aksioneret e pranishem apo te perfaqesuar.*

13.4. Duke filluar nga momenti i lajmerimit te mbledhjes se Asamblese se *Pergithshme te Zakonshme vjetore, cdo aksioner ose perfaqesues I tij, qe do ta* perfaqesoje ne asamble ka te drejte te informohet per te gjitha ceshtjet qe prashikohen ne nenin 143 te Ligjit nr. 7638, dt. 19.11.1992 "Per shoqerite Tregtare" dhe sidomos per:

- ✓ Regjistrimin ne bilancin vjetor
- ✓ *Listen e anetareve te Keshillit Mbikeqyres dhe Drejtorise, te pakten* 15 dite perpara mbledhjes.
- ✓ Raportet e Drejtorise, Keshillit Mbikeqyres dhe te Eksperteve kontabel te Autorizuar.

✓ Shumen e shperblimit te caktuar per personat e mesiperm

## NENI 14

14.1. Mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve ka kompetencen e ndryshimeve ne statut.

14.2. Mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionereve quhet e vlefshme, nese ne mbledhjen e saj te pare marrin pjese aksioneret, te pranishem apo te perfaqesuar, te cilet zoterojne te pakten 50 % te aksioneve me te drejte vote. Ne rast se nuk arrihet shumica e kerkuar me siper, atehere thirret nje mbledhje e dyte, e cila quhet e vlefshme, nese marrin pjese aksioneret, te *pranishem apo te perfaqesuar, qe zoterojne 25% te aksioneve me te drejte vote.* Mbledhja e dyte thirret jo me vone se dy muaj nga mbledhja e pare.

14.3. Mbledhja e Asamblese se Zakonshme te Aksionereve vendos me shumicen prej tre te katertave te aksionereve te pranishem apo te perfaqesuar.

## B. KESHILLI MBIKEQYRES

## NENI 15

15.1 Keshilli Mbikeqyres perbehet nga 3 anetare.

15.2 Dy nga anetaret e ketij Keshilli zgjidhen nga Asambleja e zakonshme e Aksionereve. *Anetari i trete i Keshillit Mbikqyres zgjidhet nga punemarresit me* votim te fshehte.

15.3. Anetaret e zgjedhur nga Asambleja e pare e Aksionereve jane:

1. **Dr. Neyyir Tuncay Eren**, nenshtetas Turk, i datelindjes 1961, me numer pasaporte TR-A 243171.

2. **Z. Ahmet Malkan**, Kryetar i Keshillit Drejtues, nenshtetas Turk, i datelindjes 25.11.1952, vendlindja Elazig, Turqi, vendbanimi Ankara Turqi, me numer pasaporte TR-A-107683.

15.3 Mandati I anetareve te Keshillit Mbikeqyres eshte 4 ( kater ) vjet.Ata jane te rizgjedhshem.

15.4. Anetaret e Keshillit Mbikeqyres jane persona fizike ose juridike. Drejtori nuk mund te jete anetar i Keshillit Mbikqyres.

**NENI 16**

16.1. Keshilli Mbikeqyres zgjedh nga anetaret e tij nje Kryetar dhe nje Zevendeskryetar, te cilet therrasin Mbledhjet e keshillit dhe drejtojne diskutimet.

16.2. Ne rast mungese te kryetarit, mbledhjet e keshillit kryesohen nga zevendeskryetari.

**NENI 17**

17.1. Mbledhja e Keshillit thirret nga Kryetari. Kryetari eshte i detyruar te therrase Keshillin Mbikeqyres brenda 15 diteve nga paraqitja e kerkeses se motivuar prej Drejtorit te Shoqerise, ose te 1/3 te anetareve te vete Keshillit.

17.2. Thirrja e mbledhjes behet 3 dite perpara dates se caktuar, nepermjet nje letre rekomande, apo ne cdo menyre tjeter, te pranuar nga anetaret e vete Keshillit.

17.3. Mbledhjet e Keshillit Mbikeqyres zhvillohen si rregull ne seline e shoqerise, ne qender apo filiale, por edhe ne cdo vend tjeter te caktuar paraprakisht dhe te bere publik nga thirresi I mbledhjes. Keshilli Mbikqyres mund te organozoje mbledhje dhe te marre vendime te vlefshme me ane te konsultimit me shkrim, nepermjet faxit, e-mailit apo postes. Ne kete rast vendimet duhet te nenshkruhen nga te gjithe anetaret.

17.4. Vendimet e marra ne mbledhjet e Keshillit Mbikeqyres jane te vlefshme nese ne mbledhje marrin pjese te pakten dy anetare. Vendimet merren me shumice te thjeshte te anetareve te pranishem. Ne rast se numri i te pranishmeve eshte çift dhe votat jane te barabarta, atehere vota e Kryetarit eshte vendimtare.

**NENI 18**

18.1. Keshilli Mbikeqyres emeron dhe shkarkon Drejtorin.

18.2. Keshilli Mbikeqyres ushtron kontroll te vazhdueshem ndaj Drejtorise persa i perket administrimit te shoqerise nga ana e saj. Ai ka te drejte te kryeje ne çdo kohe verifikimet dhe kontrollet qe i çmon te arsyeshme dhe te kerkoje te njihet me dokumentat qe i gjykon te nevojshem.

18.3. Drejtori i paraqet raport Keshillit Mbikqyres te pakten njehere ne tre muaj. Keshilli Mbikqyres orienton dhe keshillon Drejtorin.

18.4. Keshilli Mbikeqyres i paraqet Asamblese se Aksionereve verejtjet e tij mbi raportin e nxejerre nga Drejtoria, ne perputhje me nenin 130 te Ligji nr. 7638, date 19.11.1992, "Per shoqerite tregtare".

**C. DREJTORIA**

**NENI 19**

19.1. Drejtoria perbehet nga nje Drejtor i vetem, person fizik. Mandati i Drejtorit eshte 3 (tre) vjeçar, me te drejte rizgjedhjeje.

19.2. Drejtori eshte organi administrativ i shoqerise. Ai perfaqeson shoqerine ndaj te treteve dhe vepron me kompetenca te plota ne emer te shoqerise brenda objektit dhe limiteve te percaktuara nga ky statut, nga ligji dhe nga vendimet e asamblese se aksionereve.

19.3. Drejtori shkarkohet nga Keshilli Mbikqyres, per nje shkak te perligjur, ne *perputhje me kerkesat e nenit 98 te Ligjit Nr, 7638 date 19.11.1992 "Per* Shoqerite Tregtare". Jane veçanerisht shkaqe te perligjura: faji i rende ne kryerjen e detyrave te tij, paaftesia, humbja e besimit, shkaktimi i demve shoqerise.

19.4. Te drejtat dhe detyrimet e Drejtorit percaktohen ne menyre te detajuar ne *aktin e emerimit, te perpiluar nga Keshilli Mbikqyres.*

**D. KONTROLLI I SHOQERISE**

**NENI 20**

20.1 Kontrolli i shoqerise ushtrohet nga nje ekspert kontabel te autorizuar. *Eksperti i Pare kontabel i autorizuar eshte* ***Paqesor Qato***.

20.2 Lidhur me kompetencat e ekspertit kontabel te autorizuar te shoqerise, *papajtueshmerite e tij, emerimin, mandatin dhe çeshtje te tjera qe lidhen me*

erkspertet kontabel do te zbatohen kritetret e parashikuara ne nenet 167 e vijues te Ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerine Tregtare".

20.3 Auditimi vjetor i llogarive te shoqerise do te behet sipas standartit nderkombetar te auditimit.

**KAPITULLI IV**

**LLOGARITE , VITI FINANCIAR, INVENTARI**

**NENI 21**

21.1 Shoqeria mban ne zyrat e saj librat e kerkuar nga ligji,ku mbahen llogarite vjetore, tabelat financiare vjetore, bilancet ekonomike vjetore raportet ekonomike vjetore,ne te cilat duhet te perfshihen dhe çdo kerkese tjeter ligjore.

**NENI 22**

22.1 Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 muajsh, duke filluar nga 1 Janari e deri me 31 Dhjetor te cdo viti. Perjashtim ben viti i pare finaciar, i cili fillon me rregjistrimin ne gjykate dhe mbaron me date 31 Dhjetor.

**NENI 23**

23.1. Kapitali reazerve i domosdoshme krijohet nga mbajtja e te pakten nje shume prej 1/20 te fitimeve neto te shoqerise, pasi jane zbritur me pare humbjet e mundshme te viteve te kaluara.

23.2. Kjo procedure pushon se qeni e detyrueshme kur shuma e kapitalit te rezervuar arrin masen 1/10 e kapitalit te shoqerise;

**NENI 24**

24.1. Fitimet qe do te ndahen perbejne fitimet e vitit finanaciar, mbasi te jene zbritur humbjet e mundeshme te viteve me pare sipas nenit te mesiperm.

**NENI 25**

25.1. Mbas mbarimit te bilancit vjetor dhe rregjistrimin e shumes qe do te ndahet, Asambleja e Zakonshme percakton shperndarjen e divideteve, ne baze te kapitalit te aksionereve, sipas neneve 215, 216 te ligjit Nr. 7638 date 19.11.1992 " Per shoqerite tregtare".

**KAPITULLI VI**

**PRISHJA E SHOQERISE DHE LIKUJDIMI**

**NENI 26**

26.1. Likujdimi i shoqerise behet ne baze te dispozitave te percaktuara nga ligji. Shoqeria ben likujdimin e saj qe ne momentin e prishjes se saj per cdo lloj arsyeje.

26.2 Ne\mertimin e shoqerise ne fazen e likujdimit perfshihet edhe shprehja " ne likujdim e siper" Ky tregues dhe emri i likujdatorit shenohen ne te gjitha veprimet dhe dokumentat qe leshohen nga shoqeria tek te tretet.

26.3. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete statut, si dhe gjate themelimit te shoqerise, zbatohen dispozitat ligjore ne fuqi per Shoqerite Anonime " Pa oferte publike"

***Ky statut nenshkruhet nga aksioneret themelues, me daten __17/02/06__, ne __Tirane__, perpara noterit.***

**AKSIONERET THEMELUES TE SHOQERISE**

Shoqeria Tregtare

***« ENAR Saglik Hizmetleri »***

**Dr. Neyir Tuncay Eren**

Neyir Tuncay Eren

Shoqeria Tregtare

**« TEK-IMAS »**

**Z. Ahmet Malkan** Ahmet Malkan

**Z. Klodian Allajbeu**

Klodian Allajbeu

Përkthyes
Dorian Luci